

Departamenti i Auditimit të Performancës në KLSH zhvillon në Universitetin “Fan S. Noli” workshop-in për planin e auditimit në vitin 2024

6-7 nëntor 2023

Në kuadër të hartimit të planit vjetor të auditimeve për vitin 2024, Departamenti i Auditimit të Performancës në Kontrollin e Lartë të Shtetit finalizoi në një takim të zhvilluar në mjediset e Universitetit “Fan S. Noli”, procesin e përgatitjes dhe propozimit temave të auditimit për vitin e ardhshëm.

Në zbatim të Metodologjisë së Planifikimit Vjetor të Auditimeve në KLSH dhe Manualit të Auditimit të Performancës, temat e propozuara për auditime në vitin 2024 nga audituesit e Departamentit të Auditimit të Performancës, kishin në fokus disa fusha, si: arsimi, shëndetësia, shërbimet sociale, shërbimet shtetërore, shërbime publike, pushteti vendor, mjedisi, turizmi, kultura etj.



Në workshop-in me temë “*Mbi përgatitjen e planit të auditimeve të KLSH-së, për vitin 2024*”, të zhvilluar në datat 6-7 nëntor 2023 në ambientet e Universitetit të Korçës mori pjesë edhe Prof. Alketa Pasholli, si përfaqësuese e këtij institucioni të arsimit të lartë. Prof. Alketa Pasholli vlerësoi bashkëpunimin e KLSH-së me Universitetin “Fan S. Noli”, si një risi në procesin e planifikimit të temave të auditimit të performancës, duke treguar interes për fushat e auditimit të propozuara nga audituesit.

Gjatë dy ditëve të workshop-it, audituesit prezantuan temat e auditimit duke u ndaluar edhe në diskutime për fushat e propozuara në lidhje me impaktin social apo publik, si dhe evidentimin e kontributit të KLSH-së përmes auditimeve të performancës për përmirësimin e eficiencës dhe efektivitetit në shërbimet publike që u ofrohen taksapaguesve, duke ekonomizuar njëkohësisht përdorimin e fondeve publike.

